



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT NË FUSHËN E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL**

Nr. 5044 / prot.
1

Tiranë, më 25.06.2026

U R D H Ë R

Nr. 675, datë 25.06.2026

PËR

**ZGJATJEN E AFATIT TË APLIKIMEVE NË SKEMËN KOMBËTARE TË
MBËSHTETJES PËR VITIN 2026**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 3, të nenit 6 të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, "*Për bujqësinë dhe zhvillimin rural*", të shkronjës "c", pika 2, të nenit 18, të ligjit nr. 64/2012, "*Për peshkimin*", të ndryshuar, të ligjit Nr. 87/2025, "*Për buxhetin e vitit 2026*", të VKM nr. 205, datë 30.3.2026, "*Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2026*", si dhe të pikës (b), të Kreut IV, të Udhëzimit nr 8, datë 14.5.2026 "*Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për masat mbështetëse për vitin 2026*",

URDHËROJ:

1. Zgjatjen e afatit të aplikimeve, për të gjitha masat mbështetëse të përcaktuara në Udhëzimin nr 8, datë 14.5.2026 "*Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për masat mbështetëse për vitin 2026*", deri në datën 6.7.2026, ora 16:30.
2. Ngarkohet Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren zyrtare.

MINISTËR

Andis Salla

